



Datë: 30.04.2025

Numër protokoli: 2907/2025

A.nr.498/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtare, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.498/2025 të datës 19.03.2025 të parashtruar nga ankuesi P.I., kundër organit të punësimit/Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*Vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.498/2025 e datës 19.03.2025 e parashtruar nga ankuesi P.I.

A r s y e t i m

Ankuesi P.I (*tani e tutje referuar: ankuesja*), më datë 19.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.498/2025, kundër Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024 i datës 19.02.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Fushë Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 01.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 1782/2025 të datës 19.03.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 19.02.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; E-mailin e datës 28.02.2025 dërguar nga V.K për F.D me korrespondencën e bashkangjitur; E-

mailin e datës 14.03.2025 dërguar nga S.Sh për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 14.03.2025 dërguar nga J.M për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 17.03.2025 dërguar nga S.S për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 14.03.2025 dërguar nga P.I për B.M me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 17.03.2025 dërguar nga B.M për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 21.03.2025; Përgjigja e datës 24.03.2025; Akt Emërimin e ankuesit i datës 10.10.2019;

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimin të datës 10.10.2019 është i punësuar në pozitën *Zyrtar për Bujqësi*, në kuadër të Komunës së Fushë Kosovës. Tutje sipas shkresave të lëndës, rezulton se mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë Udhëheqësi i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, sipas Formularit të datës 19.02.2025 për vlerësimin e rezultateve të punës, ankuesin për vitin 2024 e ka vlerësuar me notën e përgjithshme: ***Arrinë pritshmërinë.***

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër formularit të vlerësimin të rezultateve në punë për vitin 2024, pretendon vlerësimi nuk është i drejtë sa i përket pikave 1.3 dhe 1.4 që ka të bëjë me vlerësimin e aftësive profesionale dhe komunikimit me ekipën, më arsyetimin dhe provat e bashkangjitura se i njëjti ka raporte dhe komunikim të mirë me kolegët.

Në vazhden e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të palës ankuese, Kolegji i Këshillit, mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenin 52 paragrafi 13, 14, 15, dhe 17, përcakton se: “13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; **13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.** 14. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafëve 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësja/i duhet t'i ndjekë vitin që vjen dhe sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. **17. Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”.**

Po ashtu, duke u mbështetur në nenin 52 paragrafi 18 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 të Rregullores (QRK) NR. 26/2024 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë ku përcaktohet se: “Vlerësimi sipas niveleve bëhet si më poshtë: **“Arrinë pritshmërinë”** është vlerësim që tregon se nëpunësi civil ka përmbushur me sukses të gjitha detyrat dhe kërkesat e vendosura për rolin e tij. Performanca e tij është në përputhje me objektivat e vendosura, sjelljes profesionale dhe sjelljes personale”, ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 1 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: “1. Nëpunësi civil i pakënaqur me vlerësimet **“e papranueshme”**

dhe “**ka nevojë për përmirësim**” ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve”. Kolegji i Këshillit erdhi në konstatimin, se ligji material, respektivisht Ligji nr.08/L197 për Zyrarët Publik dhe akti nënligjor që trajton apo rregullon çështjet nga fusha e vlerësimit të rezultateve në punë, ka përcaktuar se nëpunësit civil vetëm për dy lloje apo dy nota të vlerësimit kanë të drejtë në ankesë, respektivisht vetëm lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë në rastet e vlerësimit “**e papranueshme**” dhe “**ka nevojë për përmirësim**”.

Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme **Arrinë pritshmërinë**, atëherë Kolegji i Këshillit duke ju referuar paragrafit 17 të nenit 52 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe 14 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) NR. 26/2024 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, konstaton se në këtë rast nuk lejohet parashtrimi i ankesës në për këtë çështje-apo lloj të vlerësimit, andaj referuar dispozitave të lartcekura po ashtu edhe dispozitave të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji”, kështu që meqë ankesa në rastin e tillë është përjashtuar shprehimisht me ligj, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa me numër A.nr.498/2025 e datës 19.03.2025 e parashtruar nga ankuesi është e palejuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.498/2025, datë 30/04/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit P.I;
- Komunës së Fushë Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.